



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Për përkrahje me mekanizëm bujqësor – pajisje bujqësore

*(Subvencione në kuadër të sektorëve të lavërtarisë, blegtorisë, pemëtarisë,
perimtarisë, vreshtarisë dhe shpezëtarisë)*

Gjakovë, shtator 2026

Në kuadër të mbështetjes për zhvillimin e sektorëve të lavërtarisë, blegtorisë, pemëtarisë, perimtarisë, vreshtarisë dhe shpezëtarisë, si dhe modernizimin e kapaciteteve prodhuese të fermerëve në Komunën e Gjakovës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, shpall këtë thirrje publike me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në prodhimin e produkteve bujqësore dhe mbështetjes së fermerëve me pajisje bashkëkohore.

Ftohen fermerët e Komunës së Gjakovës të aplikojnë për përkrahje me njërin nga pajisjet në vijim:

- **Spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut (20 përfitues);**
- **Freza 1,65 m (19 përfitues);**
- **Freza 2,25 m (15 përfitues);**
- **Pllug 3-brazdësh statik (10 përfitues);**
- **Motokultivator 4,4 kW (20 përfitues);**
- **Motokultivator 9,0 kW (5 përfitues);**
- **Mikser për përgatitjen e ushqimit të kafshëve, 500 kg (10 përfitues);**
- **Mbjellëse gruri, 22-rreshtëshe (10 përfitues);**
- **Rotokosë 165 (11 përfitues).**

KRITERET E PRANUESHMËRISË

- Aplikuesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Të jetë aplikues në skemën e Pagesave Direkte në kuadër të MBPZHR-së për vitin 2026;
- Fermeri mund të aplikojë vetëm për një pajisje;
- Përfituesi duhet të bashkëfinancojë vlerën e pajisjes me së paku 20%;
- Aplikuesi të mos ketë përfituar subvencione nga Komuna gjatë vitit paraprak dhe vitit aktual;
- Përparësi do t'u jepet fermerëve që nuk kanë përfituar nga skemat komunale gjatë viteve të fundit;
- Përparësi do t'u jepet fermerëve blegtoralë;
- Përparësi kanë gratë fermerë, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë;
- Ndarja e përfituesve do të bëhet në mënyrë proporcionale sipas pesë (5) rajoneve të Komunës së Gjakovës;
- Aplikuesit për **spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut** duhet të kenë së paku 3.00 ha sipërfaqe të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **freza 1.65 m** duhet të kenë së paku 0.50 ha sipërfaqe vreshtari, 0.50 ha sipërfaqe pemëtari, 1.00 ha sipërfaqe perimtari, 3.00 ha sipërfaqe lavërtari të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **freza 2.25 m** duhet të kenë së paku 1.00 ha sipërfaqe vreshtari, 1.00 ha sipërfaqe pemëtari, 2.00 ha sipërfaqe perimtari, 7.00 ha sipërfaqe lavërtari të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **pllug 3-brazd statik** duhet të kenë së paku 5.00 ha sipërfaqe të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **motokultivator 4.4 KW** duhet të kenë së paku 0.50 ha sipërfaqe pemëtari, 0.50 ha sipërfaqe perimtari të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **motokultivator 9.0 KW** duhet të kenë së paku 3.00 ha sipërfaqe pemëtari, 3.00 ha sipërfaqe perimtari, së paku 10.00 ha sipërfaqe lavërtari të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **mbjellëse gruri 22-rendëshe** duhet të kenë së paku 15.00 ha sipërfaqe me grurë të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **mikser për përgatitjen e ushqimit të kafshëve 500 kg** duhet të kenë së paku 10 lopë qumështore, së paku 10 viça për majmëri, së paku 100 dele për mbarështim, së paku 100 dhi për mbarështim ose së paku 2 000 pula vojse të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit për **rotokosë 165** duhet të kenë së paku 10 lopë qumështore, së paku 10 viça për majmëri, së paku 100 dele për mbarështim ose së paku 100 dhi për mbarështim të aplikuar në kuadër të Pagesave Direkte për vitin 2026.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

- Fotokopje e letërnjoftimit;
- Kopje e Numrit Identifikues të Fermerit (NIF);
- Vërtetim mbi tatimin në pronë;
- Certifikatë mbi pronësinë e paluajtshme – lista poseduese;
- Dëshmi për aplikimin në skemën e Pagesave Direkte për vitin 2026;
- Deklaratë nën betim;
- Vërtetim për gjedhet nga veterineri (për aplikuesit për pajisjet: rotokosë dhe mikser për përgatitjen e ushqimit të kafshëve);
- Certifikatë veterinare-shëndetësore, e lëshuar nga praktikant veterinarë të licencuara nga AUV-ja (për aplikuesit në sektorin e shpezëtarisë).

Formulari i aplikimit mund të merret në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Gjakovës.

AFATI I APLIKIMIT

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është nga **17.09.2026** deri më **01.10.2026**.

MËNYRA DHE ADRESA PËR DORËZIMIN E APLIKACIONEVE

Aplikacionet e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar dorëzohen në **Arkivin e Komunës së Gjakovës**, në adresën:

Komuna e Gjakovës

Rr. "UÇK"

50000 Gjakovë

MËNYRA E VLERËSIMIT TË APLIKACIONEVE

Vlerësimi i aplikacioneve do të zhvillohet në dy faza:

Faza e parë – Shqyrtimi administrativ

Në këtë fazë do të bëhet verifikimi i aplikacioneve dhe dokumentacionit të dorëzuar, me qëllim të konstatimit nëse aplikacionet janë të plota dhe i përmbushin kërkesat administrative të përcaktuara në këtë thirrje publike.

Vetëm aplikacionet që i plotësojnë kërkesat administrative do të kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit.

Faza e dytë – Vlerësimi i kritereve

Aplikacionet që kalojnë shqyrtimin administrativ do të vlerësohen sipas kritereve të përcaktuara në këtë thirrje publike.

Vlerësimi do të bëhet përmes sistemit të pikëzimit, bazuar në kriteret e miratuara, ndërsa dokumentacioni administrativ nuk do të jetë pjesë e kësaj faze të vlerësimit.

KUSHTET DHE MËNYRA E PARASHTRIMIT TË PYETJEVE SQARUESE

Të gjithë aplikuesit e interesuar mund të parashtrojnë pyetje sqaruese lidhur me këtë thirrje publike gjatë periudhës së aplikimit.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural do të ofrojë sqarimet e nevojshme në kohë, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë aplikuesit.

KUSHTET DHE MËNYRA E PARAQITJES SË ANKESAVE

Aplikuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj rezultateve të kësaj thirrjeje publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesat paraqiten me shkrim në **Arkivin e Komunës së Gjakovës**, brenda afatit ligjor, nga dita e publikimit të rezultateve.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Drejtore i Drejtorisë
Gani Hajdari

